

# Vendim Nr.38 datë 28.02.2019

## PËR PAGESAT E GJYQTARËVE NË DITËT E PUSHIMIT JAVOR DHE FESTAVE ZYRTARE

Në mbështetje të nenit 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 11, pika 3 germa “ç” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 97, pika 1, germa “b” të Ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenit 91 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

### U D H Ë Z O N:

- i Gjyqtari që ushtron funksionin në ditët e pushimit javor apo festave zyrtare, përfiton shtesë page në masën 50% të pagës së tij ditore.
- i Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë dhe/ose gjyqtari i gjykatës së apelit kompensohet financiarisht sipas pikës 1, vetëm nëse gjykon çështje urgjente, për të cilat dispozitat procedurale parashikojnë se duhet të vendoset brenda 24-72 orëve nga regjistrimi i çështjes në gjykatë.
- i Në çdo rast gjykata duhet të ketë fonde të miratuara për këtë qëllim në buxhetin vjetor të saj.
- i Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij udhëzimi, fillojnë në datën 1 janar 2019. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR

KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR